



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:062678
Datë: 15.04.2024
Numri i dokumentit: 05572372

PA1.nr.181/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm – kolegji i përbërë nga gjyqtarët Abdullah Ahmeti - kryetar i kolegjit, Ferit Osmani dhe Mehmet Ndrecaj - anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Rrezarta Bala, në çështjen penale ndaj të akuzuarës A. Ç. , nga P., për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik, nga neni 370 par.8 e lidhur me par.6 dhe par.1, të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit së të akuzuarës A. Ç. - av. M. N. , të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Pejë, P.nr.355/20, datë 17.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur, më datë 03.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e mbrojtësit së të akuzuarës A. Ç. av. M. N. , ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, P.nr.355/20, datë 17.11.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë, me aktgjykimin P.nr.355/20, datë 17.11.2023, të akuzuarën A. Ç. e ka shpallur fajtor, për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik, nga neni 370 par.8 e lidhur me par.6 dhe par.1, të KPRK-së, dhe e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj i cili dënim në kuptim të nenit 44 par. 1 dhe 2 të KPRK-së, me

pëlqimin e të akuzuarës i është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumen prej 3.000 (tre mijë) € e të cilin dënim e njëjta obligohet ta paguaje në afat prej 6 (gjashtë) muaj, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse e akuzuara refuzon, dështon apo nuk paguan dënimin e shqiptuar me gjobë në afatin e caktuar, ky dënim do të i zëvendësohet me dënim burgimi duke i llogaritur shumen prej 20 (njëzetë) €, për një ditë burgimi. Nëse e njëjta nuk dëshiron ose nuk mund të paguaje gjobën në tërësi, gjykata do ta zëvendësoje pjesën e mbetur të gjobës me burgim. Nëse e njëjta e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit me burgim ndërpritet. Është obliguar e akuzuara gjykatës t'i paguan shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 30 (tridhjetë) €, si dhe shumën prej 20 (njëzetë) €, në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit. Personat e autorizuar, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest juridiko civil. Konform nenit 59 par. 2 nën par. 2.5 e lidhur me nenin 64 par. 1 dhe par. 2 të KPRK-së gjykata të akuzuarës i shqipton, dënim plotësues – ndalim i drejtimit të automjetit, të akuzuarës i ndalohet drejtimi i automjetit në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit. Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur :

Mbrojtësi i të akuzuarës A. Ç. av. M. N. , për shkak të vendimit mbi dënimin, duke i propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës, të e aprovoj ankesën, aktgjykimin e ankimuar të e ndryshoj dhe të akuzuarës të i shqiptoj dënim më të lehtë si dhe të revokohet dënimi plotësues i shqiptuar.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtrësën PPA/II.nr.190/2024, të datës 05.02.2024, ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit së të akuzuarës, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pasi mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoj pretendimet ankimore dhe analizoj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), konstatoj se :

- Ankesa është e pabazuar.

Edhe pse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve të ligjit penal, megjithatë kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, duke u bazuar në nenin 394 paragrafi 1 të KPP, sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar edhe në këto drejtime dhe konstatoj se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarës, të cilat do e kishin e kushtëzuar anulimin e tij.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse e akuzuara në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par. 2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose

marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen faktike, andaj aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore sa i përket vendimit për dënim.

Mbrojtësi i të akuzuarës A. Ç. - av. M. N. e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë sa i përket vendimit mbi dënimin duke pretenduar që gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të dënimit për të akuzuarën ka gjetur si rrethanë lehtësuese, pranimin e fajësisë, sjelljen e saj të paqortueshme në gjykatë, faktin se më parë nuk ka rënë ndesh me ligjin, se është bashkëshorte dhe nënë e tre fëmijëve, ndërsa në anën tjetër si rrethanë rënduese nuk ka gjetur. Dënimi i shqiptuar nuk përkon me rrethanat lehtësuese të cekura si më lartë. Përkundër rrethanave të përmendura më lartë, mbrojtja ka propozuar që si rrethana lehtësuese të trajtohet edhe fakti se nga koha e kryerjes së veprës penale kanë kaluar rreth katër vite, duke bërë që e mbrojtura ime ti kthehet jetës normale pa u përfshirë në ndonjë veprim tjetër, pasi që e njëjta punon si mësimdhënëse në fshatin R. dhe se është përditshmëria që e obligon që të udhëtoj me veturë. Dënimi i shqiptuar në shumë prej 3.000 (tremijë) €, është shumë i lartë në raport me të ardhurat që ajo i realizon pra pagën mujore prej 541 €. Edhe dënimi plotësues – ndalim i drejtimit të automjetit është i rëndë duke qenë se paraqet hendikep të madh në përditshmërinë edhe me realizimin e nevojave personale dhe familjare. I propozon Gjykatës së Apelit të Kosovës, të e aprovoj ankesën, aktgjykimin e ankimuar të e ndryshoj dhe të akuzuarës të i shqiptoj dënim më të lehtë si dhe të revokohet dënimi plotësues i shqiptuar.

Sipas vlerësimit të kolegjit penal të Gjykatës së Apelit të Kosovës, pretendimet ankimore të paraqitura në ankesën e mbrojtësit së të akuzuarës, për shqiptimin e dënimit më të lehtë, ndaj të akuzuarës, janë të pabazuara. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në përgjithësi drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa në ankesën e lartcekur nuk është paraqitur ndonjë rrethanë e rëndësishme dhe e posaçme që nuk është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë, e cila do ta arsyetonte për shqiptimin e dënimit më të lehtë, ndaj të akuzuarës. Kështu, gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarës e duke u bazuar konform të dispozitës së nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, gjykata si rrethana lehtësuese gjeti se e akuzuara e ka pranuar fajësinë, sjelljen e saj të paqortueshme në gjykatë, faktin se më parë nuk ka ra ndesh me ligjin, se është bashkëshorte dhe nënë e tre fëmijëve, ndërkaq nga rrethanat rënduese gjykata në rastin konkret gjykata për të akuzuarën nuk gjeti asgjë. Andaj, duke i pasur parasysht të gjitha rrethanat e lartcekura gjykata e shkallës së parë i shqiptoi të akuzuarës dënimin sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar me bindjen se edhe me një dënim të tillë do arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së. Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa rrethanat e pretenduara lehtësuese në ankesën e mbrojtësit së të akuzuarës, sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk janë të atij karakteri dhe nuk kanë ndikim që të akuzuarës t'i shqiptohet një dënim tjetër nga ai të cilin e ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë apo që akuzuarit të i shqiptoj dënim më të lehtë dhe ti revokohet dënimi plotësues, sikurse që pretendohet në ankesë, të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, andaj duke marrë parasysht rrethanat e konstatuara dhe

drejtë të vlerësuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, del se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarës është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarës si ekzekutore dhe se kjo do t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve, se me këtë kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të bëhet rehabilitimi e saj. Andaj kolegji penal i kësaj gjykate konsideron se dënimi i shqiptuar është i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart dhe në bazë të nenit 401 të KPP, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.181/24, më datë 03.04.2024

Zyrtarja ligjore;
Rrezarta Bala

Kryetari i kolegjit
Abdullah Ahmeti

Anëtarët e kolegjit:
Ferit Osmani

Mehmet Ndrecaj